

Në bazë të nenit 9 paragrafit 4 të Ligjit për Zejtari (Gazeta Zyrtare e RM” nr.215/15), ministri i ekonomisë solli

## **RREGULLORE PËR FORMËN, PËRMBATJEN DHE MËNYRËN E MBAJTJES SË REGJISTRIT TË ZEJTARËVE**

### Neni 1

Me këtë rregullore, përshkruhet forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së Regjistrit të Zejtarëve.

### Neni 2

Regjistri i Zejtarëve mbahet në formë të librit me kapak të fortë me dimensione 430 x 300 në listat e evidencës, që janë të lidhura dhe të numëruara. Libri është me kapakë të kaltërt dhe në anën e përparme ka mbishkrimin me shkronja me ngjyrë të artë: “Regjistri i Zejtarëve”

Lista e Evidencës nga pika 1 e këtij neni i përmban të dhënat mëposhtme:

1. numri rendor;
2. numri i regjistrimit;
3. emri, emri i babait dhe mbiemri i zejtarit bartës i lejes zejtare;
4. NUAQ I zejtarit / NUAS i TI i SHT;
5. adresa e banimit të zejtarit, kryerësit të veprimtarisë zejtare;
6. përgatitja profesionale;
7. numri dhe data e aktvendimit për regjistrim/leja zejtare;
8. emri firmës së zejtarit TI, SHT dhe emri i shkurtuar i firmës;
9. selia e zejtarit TI, SHT, telefon, email, ueb faqe;
10. veprimtaritë zejtare (kodi dhe emri);
11. lloji i veprimtarisë zejtare (prodhimtari zejtare, shërbime zejtare, veprimtari për zejtari shtëpiake dhe artistike);
12. hapësirat e punës;
13. veprimtaria kryesore zejtare;
14. numri i të punësuarve;
15. ndalesa e përkohshme e kryerjes së veprimtarisë zejtare, baza, numri dhe data e aktvendimit;
16. njoftim për vazhdimin me kryerjen e veprimtarisë zejtare;
17. të dhënat e personit që përkohësisht kryen veprimtarinë zejtare në rast të vdekjes së zejtarit;
18. ndërprerja e veprimtarisë zejtare (lejes së zejtarit, baza, numri dhe data e aktvendimit);
19. Vërejtje.

Forma dhe përmbatja e Regjistrit Zejtari janë dhënë në Shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

### Neni 3

Në Regjistrin Qendror futen të dhënat nga neni 2 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje, si dhe të gjitha ndryshimet që do të ngjajnë pas regjistrimit të kryer.

Në një Listë të Evidencës nga Regjistri i Zejtarëve futen të dhëna vetëm për një zejtari.

Pas plotësimit të listës së evidencës nga Regjistri i Zejtarëve hapet listë e re e evidencës, ku

shënohet faqja e Regjistrit prej ku është kryer transmetimi i faqes paraprake, si dhe numri i faqes së re të Regjistrit.

#### Neni 4

Regjistri i Zejtarëve mbahet në formë të shkruar dhe elektronike

#### Член 5

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje përfundon vlefshmëria e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e Regjistrit të Zejtarëve (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 87/04

#### Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”

nr. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_2022  
Shkup

Ministri i Ekonomisë,  
**Kreshnik Bekteshi n.p**

SHTOJCË

REGJISTRI I ZEJTARËVE

## REGJISTRI I ZEJTARËVE

1.	numri rendor
2.	numri i regjistrimit
3.	emri, emri i babait dhe mbiemri i zëjtarit bartës i lejes zëjtare
4.	NUAQ I zëjtarit / NUAS i TI i SHT
5.	adresa e banimit të zëjtarit, kryerësit të veprimtarisë zëjtare
6.	përgatitja profesionale
7.	numri dhe data e aktvendimit për regjistrim (leja zëjtare)
8.	emri firmës së zëjtarit TI, SHT dhe emri i shkurtuar i firmës
9.	selia e zëjtarit TI, SHT, telefon, email, ueb faqe
10.	veprimtaritë zëjtare (kodi dhe emri)
11.	lloji i veprimtarisë zëjtare (prodhimtari zëjtare, shërbime zëjtare, veprimtari për zëjtari shtëpiake dhe artistike)
12.	hapësirat e punës
13.	veprimtaria kryesore zëjtare
14.	numri i të punësuarve
15.	ndalesa e përkohshme e kryerjes së veprimtarisë zëjtare, baza, numri dhe data e aktvendimit
16.	njoftim për vazhdimin me kryerjen e veprimtarisë zëjtare
17.	të dhënat e personit që përkohësisht kryen veprimtarinë zëjtare në rast të vdekjes së zëjtarit
18.	ndërprerja e veprimtarisë zëjtare (lejes së zëjtarit, baza, numri dhe data e aktvendimit)
19.	Vërejtje